



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Lubjanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP. nr.939/2024**  
**Data e vendimit: 25.10.2024**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “Naim Shuki” B.I lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së (RITENDER)” me numër të prokurimit 616-24-7138-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”, zv. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, z. Agim Sheqiri me datën 25/10/2024, mori këtë:

### VENDIM

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e “Naim Shuki” B.I me nr. të protokollit 2024/0939, e datës 03/10/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së (RITENDER)” me numër të prokurimit 616-24-7138-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës.”

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – “Komuna e Prishtinës” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së (RITENDER)” me numër të prokurimit 616-24-7138-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

### *-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 03/10/2024, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 0939/2024 nga OE Naim Shuki B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së (RITENDER)” me numër të prokurimit 616-24-7138-1-2-1, iniciuar “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 11/07/2024 “Komuna e Prishtinës”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 22.07.2024.

OE “Naim Shuki” B.I. me 05.08.2024 ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa autoriteti kontraktues nuk i ka kthyer përgjigje siç parashihet me nenin 108/A paragrafi 7 te LPP-së.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së (RITENDER)” me numër të prokurimit 616-24-7138-1-2-1, iniciuar nga “Komuna e Prishtinës”, njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 11.07.2024 , Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 22.07.2024.

Me datën 02. 08. 2024 AK ka publikuar njoftimin B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit. Ndërsa me datë 05.08.2024, pas orës 16:00 e që i bie data 06.08.2024, OE “Naim Shuki” B.I. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigje siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së ne kërkesën për rishqyrtim te Ankuesit “Naim Shuki” B.I.

Ne këtë rast, Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtrorj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së pas vendimit të AK-së. Në rastin konkret AK nuk i është përgjigjur OE ankues në kërkesën e parashtruar.

Konfrom nenit 108/A të LPP-së në rast se AK nuk ka lëshuar një vendim apo nuk ka njoftuar Ankuesin për zgjatje të afatit të rishqyrtimit, atëherë afati për parashtrim të ankesës në OSHP fillon të rrjedhë në ditën e tretë (3) të fundit të kthimit të përgjigjes. Në rastin konkret, dita zero (0) për rrjedhje të afatit ka qenë dita e tretë (3) për kthim të përgjigjes nga AK, andaj ankuesi ka qenë dashur që të parashtrorj ankesë 10 ditë pas ditës së tretë (3) për kthim të përgjigjes nga AK.

Megjithatë Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe të Ligjit për Prokurim Publik. Megjithatë, OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna si më lartë, duke u bazuar në interpretimin e KRPP-së tek pyetjet e rregullta nr. 8 “Cilat janë afatet kohore në procedurën ankimore”, OSHP e konsideron ankesën e OE ankues si të jashtëaftashme.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”,

1x1 OE – Naim Shuki B.I.

1x1 Arhivës së OSHP-së;

**Agim SHEQIRI**  
Ud. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

